

MENDIM PARALEL

1. Unë, Etleda Çiftja, kryesuese e trupit gjykues, parashtroj mendimin paralel lidhur me aspektin procedural për sa i përket burimeve të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda.
2. Shumica e trupit gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda, duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar sipas pikës 4 të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës, për shkak të funksionit të saj si ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
3. Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e aftësive profesionale, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda, ka ushtruar këto funksione: (i) për vitet 1989 – 1998, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, (ii) për vitet 1998 – 2001, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, (iii) për vitet 2001 – 2011, inspektore në Ministrinë e Drejtësisë; (iv) për vitet 2011 – 2019, ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme; (v) nga tetori i vitit 2019 deri aktualisht është caktuar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
4. Në dosjen e administruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda, ka paraqitur 13 kërkesa nga viti 2002 deri në vitin 2014, duke kërkuar rikthimin në detyrën e prokurores sipas vendeve vakante të shpallura nga Prokuroria e Përgjithshme në vitet përkatëse, pa përfshirë kërkesat pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016.
5. Sa më sipër, në gjendjen që ishin provat e administruara, shumica në vendim duhet të arsyetonte fillimisht mbi pasjen ose jo të statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda, duke qenë se ky arsyetim është i rëndësishëm për rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon "[...] Vlerësimi i aftësisë për këshilltarët ose ndihmësit ligjorë përfshin testimin pranë Shkollës së Magjistraturës [...]" dhe pikës 2 të nenit 42 "Burimet e vlerësimit të aftësive profesionale", i cili parashikon "[...] Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollën e Magjistraturës".
6. Referuar në ligjin e kohës nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", sipas nenit 44 prokurori mund të punojë në nivele drejtuese dhe ekzekutuese të kabinetit të ministrit, në strukturat juridiko - profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e punësimit njihet si periudhë vjetërsie në punë si prokuror për efekt të kërkesave profesionale. Prokurorët që punojnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tyre rrimërohen pa konkurs prokurorë. Ky ligj nuk përcaktonte kufizim kohor për periudhën e shërbimit të prokurorëve në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë.
7. Më tej, me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, në dispozitën e titulluar “Ruajtja e statusit të prokurorit” u përcaktua se prokurorët mund të shërbejnë në strukturat juridiko-profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës për një afat deri në 4 vjet. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si prokuror për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. Ky ndryshim ligjor që hyri në fuqi në janar të vitit 2009, përcaktoi një kufizim kohor për periudhën e shërbimit në këto struktura për të gjithë prokurorët e komanduar të cilët donin të vazhdonin të ruanin statusin¹.

8. Fakti që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa herë kërkesa për t’u rikthyer në detyrën e prokurores, pavarësisht se ato nuk janë trajtuar nga organi kompetent në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese në datën 11.8.2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Gruda, nuk e kishte humbur statusin e prokurores, edhe pse nuk ishte e emëruar në detyrë.

9. Për më tepër, arsyetimi i mësipërm mbështetet edhe në faktin që Këshilli i Lartë i Prokurorisë², me anë të vendimit nr. ***, datë 11.10.2019, ka vendosur të caktojë prokuroren Pranvera Gruda në detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, çka tregon se subjekti e ka ruajtur statusin e magjistratit.

10. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk i nënshtrohet testit të Shkollës së Magjistraturës dhe, për rrjedhojë, procesi i rivlerësimit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në burimet e vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016 dhe raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Komisionere
Etleda ÇIFTJA

¹ Sipas nenit 57 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli, pasi merr mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati, mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara. Vetëm në ato raste kur magjistrati ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, Këshilli konsideron me përparësi lëvizjen paralele ose procedurat e ngritjes në detyrë. Magjistrati ka të drejtë që pas periudhës së komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj.

² Mbështetur në parashikimet e nenit 184, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në zbatim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për çështjet e mëposhtme në lidhje me të gjithë prokurorët, si: (a) emërimin; (b) caktimin në pozicion; (c) transferimin; (ç) ngritjen në detyrë; (d) komandimin dhe riemërimin; (dh) vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale; (e) vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin; (ë) çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.